

KISHA E SHËN MËRISË

Kjo kishë ndodhet afër fshatit Kallamas dhe kufirit me Maqedoninë e Veriut. Kompleksi shkëmboro - shpellor përbëhet nga dy mjedise: kupola dhe mjedisi i eremitëve. Ky monument kulturor përfaqëson një trashëgimi bizantine të fundit të shekullit të XIII dhe fillimit të shekullit të XIV.



KISHA "SHËN NIKOLLA"

Kjo kishë, e cila mban emrin e Çudibërësit "Shën Nikolla", ndodhet në veri të fshatit Pustec. Ajo përbën një prej trashëgimive të shekullit XIV. Ndonëse kjo kishë u rrënua në vitin 1967, është rindërtuar sërish në vitin 1990.

VENDBANIMI PREHISTORIK NË FSHATIN TUMINEC

Ky vend, i cili ka qënë i banuar qysh para 7000 vjetësh, përkon me epokën e neolitit të mesëm dhe përfaqëson vlerë arkeologjike dhe historiko - kulturore, jo vetëm lokale, por kombëtare dhe rajonale.

MUZEU DHE BUSTI I SPASES NË FSHATIN GOLLOMBOÇ

Busti i shkrimtarit të njohur Sterjo Spase, me origjinë nga Prespa, u inaugurua më 14 Gusht 2014, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së tij, pas një reflektimi kombëtar. Muzeu u inaugurua në Mars 2022 dhe përfaqëson një investim të një projekti ndëkufitar të Bashkimit Europian. Shkolla e dikurshme e fshatit u rikonstruktua dhe u shndërrua në muzeun "Sterjo Spase".



BAZILIKA PALEO-KRISTIANE NË FSHATIN GORICË E MADHE

Në lagjen e re ekzistojnë struktura të vjetra ndërtimore që njihen me mikrotoponimin "Vakofçinata". Bazilika i përket shekullit të VI të erës sonë me sipërfaqe 400 m2.

KULLAT E VROJTIMIT NË FSHATIN: GORICË E MADHE, GOLLOMBOÇ, DIELLAS

Këto kulla, të cilat janë ndërtuar me mure guri me gëlqere me trashësi 0,70 cm, janë trashëgimi osmane dhe i përkasin shekujve XVIII-XIX. Qëllimi i ndërtimit të tyre ishte kontrolli i patrullimeve në rrugë dhe lëvizjeve në liqen.

KISHA E SHËN DHIMITRIT NË FSHATIN KALLAMAS

Kjo kishë, e cila daton që në shekullin XI, është një ndër më të vjetrat në Bashkinë Pustec. Sikurse çdo kishë, ajo përbëhet nga dy mjedise: Naosi dhe Alltari.

SHPELLA E TRENIT

Shpella e Trenit, e njohur edhe si "Gryka e Ujkut", ndodhet në pjesën perëndimore të liqenit të Prespës së Vogël dhe daton nga viti 6000 p.e.s, ajo vazhdon të studiohet edhe në ditët e sotme për vlerat e saj historike dhe natyrore. Ka qënë vendbanim prehistorik i njeriut të lashtë, nga neoliti i hershëm deri në epokën e hekurit. Në brendësi, shpella është e gdhendur me piktura të mrekullueshme murale prehistorike kryesisht me skena gjahu. Brenda shpellës gjatë verës takohen koloni prej 2000-2500 lakuriqë nate por edhe specie insektesh dhe jorruazorë të tjerë, karakteristike e shpellave të errëta.

ATRAKSIONET NATYRORE DHE KULTURORE



NË PARKUN KOMBËTAR TË PRESPËS

PARKU KOMBËTAR I PRESPËS

Turizmi në Prespë përfaqëson një kombinim unik të pasurisë natyrore dhe kulturore, duke e bërë rajonin një destinacion të rëndësishëm për vizitorët vendas dhe të huaj. Parku Kombëtar i Prespës, me biodiversitetin e tij të jashtëzakonshëm dhe peizazhet mahnitëse, tërheq dashamirës të natyrës dhe të shpendëve të rrallë, si dhe adhurues të ekoturizmit. Monumentet historike dhe kulturore, si kishat bizantine dhe manastiret e shekujve të kaluar, tregojnë një trashëgimi të pasur që lidhet me traditat dhe historinë e rajonit. Për më tepër, atraksionet natyrore, si ishulli i Maligradit dhe gjeomonumentet si Zgavra e Zaverit, ofrojnë mundësi unike për eksplorim dhe edukim. Kjo ndërthurje e vlerave natyrore dhe kulturore e bën turizmin një faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm në Prespë.

ISHULLI I MALIGRADIT DHE KISHA E SHËN MËRISË

Ishulli i Maligradit ndodhet në pjesën jugore të liqenit të Prespës së Madhe dhe vlerësohet për bukuritë natyrore dhe vlerat kulturore. Ky gjeomonument përmban trashëgimi kulturore të hershme, qysh nga epoka e bronzit të mesëm deri në shekullin e XVII. Pasuria më e çmuar e tij është Kisha e Shën Mërisë, një kishë eremite-bizantine e shekullit të XIV. E restauruar dhe e rinovuar së fundmi me mbështetjen e një projekti ndërkufitar të Bashkimit Europian, ajo është një nga më tërheqëset e rajonit.

ZGAVRA E ZAVERIT

Ky atraksion, i cili ndodhet në afërsi të fshatit Goricë e Vogël, përfaqësonte vendin më interesant ku vërehet "rrugëtimi nëntokësor" i ujit nga liqeni i Prespës së Madhe në liqenin e Ohrit. Ky gjeomonument ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, kulturore dhe turistike.

DUSHQET E KISHËS SË SHËN NIKOLLËS

Këto dushqe në gjendje vegjetative me diametër mbi 1 metër dhe me moshë mbi 2 shekujlore, ndodhen në afërsi të fshatit Diellas dhe konsiderohen si drurë të shenjtë.

VENJA

Venja është bimë endemike dhe aromatike me gjelbërim të përhershëm, e cila rritet rreth pyjeve të fshatit Kallamas dhe Gollomboç. Lartësia e drurit shkon deri 10-12 m dhe diametër 60-70 cm. Ajo ka një status të veçantë për shkak të përfshirjes së saj në Direktivën e Habitave të BE-së, duke e bërë një specie me interes për mbrojtjen e biodiversitetit.

PYLLI I KISHËS SË SHËN VASILIT NË FSHATIN LAJTHIZË

Ky pyll ngjan me një "oaz" me dru dushku dhe përfaqëson një nga zonat më të shenjta për komunitetin lokal duke përfshirë Kishën e "Shën Vasilit", një objekt kulti i ndërtuar në shekullin e XVIII që ka një rëndësi të veçantë historike dhe kulturore për zonën.

MANI I FSHATIT GOLLOMBOÇ

Me vendndodhje pranë kishës së Shën Mërisë, ky dru frutor natyral që piqet në Korrik-Gusht, përbën një prej monumenteve të natyrës në Parkun Kombëtar të Prespës.

KISHA EREMIT E "ËNGJËJVE"

E pozicionuar në pjesën lindore të bregut të liqenit të Prespës së Madhe, afër kufirit shtetëror me Greqinë, kjo kishë daton që prej shekullit XII-XIV. E strukturuar me kate, ku ndërthurej vendbanimi i murgjve dhe mjedisi i dekoruar me afreske e ikona lidhur me funksionalitetin e dikurshëm, tashmë përbën një atraksion kulturor shumë interesant, i cili mund të vizitohet nga turistë vendas dhe të huaj.

MANASTIRI "SHËN MARENA" NË FSHATIN KALLAMAS

Ky Manastir, i cili daton që në vitin 1888, ndodhet në veri-lindje të fshatit Kallamas, 200 metra larg bregut të liqenit të Prespës së Madhe. Ky monument kulturor përfaqëson vlera të mëdha shpirtërore për banorët e Prespës, ku çdo vit në datën 30 Korrik ata realizojnë pelegrinazhin e tyre drejt manastirit për të kremtuar Ditën e Shën Marenës.

KISHA "BLLAGOVESHTENIE" OSE E "VANGJELIZMOS"

Kjo kishë eremite ndodhet në pjesën jugore të fshatit Gollomboç, pranë toponimit "Cërna Karpa", një shpellë me lartësi 25 m. Ky monument kulture, i cili përfaqëson një trashëgimi bizantine të shekullit XIV, është i strukturuar me kate dhe ngjitja realizohet me shkallë hekuri. Pjesa e poshtme e kishës përbën vendin ku jetonin murgjit, kurse pjesa e sipërme është vendi kushtuar "Bllagoveshtenies" (lajmit të mirë).